

Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete
Sektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor

Konflikti i Juridiksionit në Kontestet Pronësore

Raport mujor – prill 2009

I. Hyrje

Si reagim ndaj numrit të madh të personave, të drejtat pronësore të të cilëve janë prekur nga ligjet diskriminuese mbi pronën të shpallura ndërmjet vitit 1989 deri në konfliktin e vitit 1999, Administrata e Përkohshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ka themeluar mekanizma për praninë të kërkesave të shumta për zgjidhjen e kontesteve pronësore në mënyrë efikase, të paanshme dhe të pavarur: Së pari, Drejtorinë për Çështje Pronësore Banesore/Komisionin për Ankesa për Çështje Pronësore Banesore, e më vonë edhe Agjencinë Kosovare të Pronës/Komisionin Kosovar për Kërkesa Pronësore.¹ Me themelimin e këtyre subjekteve UNMIK-u ka hequr juridiksionin e gjykatave të Kosovës ndaj disa llojeve të caktuara të rasteve pronësore.²

Ndonëse Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore (DÇPBB), Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore (KKPB), Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) dhe Komisioni Kosovar për Kërkesa Pronësore (KKKP) janë kryesisht përgjegjëse për të gjitha kërkesat pronësore që dalin nga ligjet diskriminuese të shpallura ndërmjet vitit 1989 deri në periudhën e konfliktit të vitit 1999, kurse gjykatat e Kosovës ende kanë rol në çështjet pronësore. Kjo krijon një huti në rastet pronësore lidhur me atë se cili institucion ka juridiksion, gjykatat, AKP/KKKP apo DÇPBB/KKPB.

Ky raport identifikon së paku tri çështje kryesore që dalin në marrëdhëniet ndërmjet AKP/KKKP, DÇPBB/KKPB dhe gjykatave të Kosovës. Së pari, Rastet e referuara nga KKPB në gjykata shpesh rezultojnë në vendime kundërtënëse, duke i lënë palët pezull sa i përket fatit të kërkesës së tyre. Së dyti, në shumë raste gjykatat nuk kanë qenë në dijeni, kanë injoruar apo kanë përdorur shumë pak vendimet e mëparshme për pronën e kontestuar të marra nga KKPB. Së treti, gjykatat kishin pranuar në mënyrë jo të duhur juridiksionin për rastet që qartësisht bien mbi juridiksion ekskluziv të KKPB apo KKKP-së.

II. Mekanizmat për trajtimin e kërkesave: AKP/KKKP dhe DÇPBB/KKPB

A. Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore dhe Komisioni për Kërkesa Pronësore Banesore

Duke pasur parasysh numrin e madh të personave, të drejtat pronësore të të cilëve janë prekur nga konflikti i vitit 1999 dhe ligjet diskriminuese mbi pronën, më 15 nëntor 1999, UNMIK-u themeloi Drejtorinë për Çështje Pronësore Banesore dhe Komisionin për Kërkesa Pronësore Banesore për të vendosur në rastet e të drejtave pronësore në Kosovë dhe për të zgjidhur kontestet mbi pronën banesore.³ Me këtë janë hequr juridiksionin prej gjykatave mbi kërkesat e caktuara pronësore dhe janë themeluar organe të posaçme, të cilat duhej të ishin të paanshme, të pavarura dhe

¹ Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 mbi Themelimin e Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore dhe Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (15 nëntor, 1999); Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale (4 mars, 2006).

² Neni 1.2, Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 .

³ Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23

efikase për zgjidhjen e kërkesave, duke përdorur përvojën ligjore në vend dhe nga jashtë.⁴

Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore ka qenë e ngarkuar me “ofrimin e udhëzimeve të përgjithshme për të drejtat pronësore në Kosovë”, duke përfshirë përgatitjen e listës së banesave të braktisura, dhënien me qira të këtyre pronave të braktisura, ofrimin e udhëzimeve dhe kryerjen e hulumtimit mbi politikat që i adresohen të drejtave pronësore.⁵ DÇPB gjithashtu “ka pranuar dhe regjistruar” kategoritë vijuese të kërkesave për pronat banesore:

Kërkesat e kategorisë A: Kërkesat nga personat fizikë, të cilëve u janë revokuar të drejtat e pronësisë, posedimit apo zotërimit të pronës banesore pas 2 marsit 1989 në bazë të legjislacionit diskriminues.

Kërkesat e kategorisë B: Kërkesat nga personat fizikë, të cilët kanë hyrë në transaksione jozyrtare të pronës banesore në bazë të vullnetit të mirë pas 23 marsit 1989.

Kërkesat e kategorisë C: Kërkesat nga personat fizikë, të cilët kanë qenë pronarë, posedues ose bartës të së drejtës për banim të patundshmërisë së banuar para 24 marsit 1999, të cilët nuk gëzojnë posedimin e pronës dhe ku prona është transferuar në baza vullnetare.⁶

KKPB ka juridiksion ekskluziv për të vendosur mbi këto kërkesa, ndonëse mund t’ia transferojë kërkesat ose pjesët e kërkesave gjykatave ose organeve administrative kur mendohet që ajo kërkesë ose një pjesë e kërkesës nuk bie nën mandatin e tij.⁷ Vendimet e KKPB-së janë të prera dhe të detyrueshme me ligj dhe nuk i nënshtrohen rishikimit nga ndonjë autoritet gjyqësor ose administrativ.⁸ Megjithatë, ekziston mundësia e serishme e marrjes parasysht të vendimeve të KKPB-së nga KKPB.⁹ Përveç gjykimit të kërkesave pronësore, KKPB vlerëson të drejtat e posedimit për pronën banesore.¹⁰

1 qershori 2003 është caktuar afati për individët për t’i parashtruar kërkesat e tyre DÇPB-së.¹¹ Deri në fillim të vitit 2007, KKPB ka vendosur për të gjitha 29,160 kërkesat e parashtruara dhe mandati i tij ka marrë fund.¹²

⁴ Po aty, neni 1.2 dhe neni 2.

⁵ Po aty, neni 1.1.

⁶ Po aty, neni 1.2 (a-c).

⁷ Po aty, neni 2.5; neni 22.1, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 mbi Kërkesat Pronësore dhe Banesore dhe Rregullat e Procedurës dhe të Provave të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore si dhe të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (31 tetor, 2000).

⁸ Neni 2.7, Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23.

⁹ Neni 14.1, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60.

¹⁰ Po aty, neni 22.5.

¹¹ Raporti final i Komisionit për kërkesa pronësore dhe banesore (2007), faqe 40, mund ta gjeni në http://www.hpdkosovo.org/pdf/HPCC-Final_Report.pdf.

¹² Po aty, fq. 72.

B. Agjencia Kosovare e Pronës

Në mars të vitit 2006, DÇPB/KKPB është pasuar nga AKP-ja.¹³ Përveç zgjidhjes së kërkesave për pronë banesore, mandati i AKP-së gjithashtu përfshinte zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën bujqësore dhe komerciale.¹⁴ Afati për pranimin e kërkesave ka skaduar më 3 dhjetor 2007. AKP që nga atëherë ka pushuar së pranuari kërkesa të reja, ndonëse ajo vazhdon me procedimin e kërkesave të pazgjidhura.¹⁵ Çdo kërkesë pronësore e dorëzuar pas Dhjetorit të vitit 2007 tani bie nën juridiksionin e gjykatave të Kosovës.

Fillimisht, funksioni parësor i AKP-së ishte pranimi dhe ofrimi i ndihmës për gjykatat në zgjidhjen e kërkesave pronësore mbi pronat e paluajtshme private dhe kërkesave për shfrytëzimin e drejtave së përdorimit mbi pronat e paluajtshme private kur pronari nuk mund t'i ushtronte këto të drejta.¹⁶ KKKP i dorëzon konkluzionet e tij gjykatës kompetente për vërtetimin ose refuzimin ose për kërkimin e informatave ose veprimeve shtesë.¹⁷ Palët mund të ankoheshin për konkluzionet e komisionit ose vendimet e gjykatës në Gjykatën Supreme të Kosovës.¹⁸

Struktura fillestare e AKP-së ka ekzistuar vetëm për gjashtë muaj, nga muaji mars deri në tetor të vitit 2006. Rregullorja pasuese e UNMIK-ut ia zgjeroi thelbësisht kompetencat për, ndër të tjera, pranimin, regjistrimin dhe zgjidhjen e kërkesave pronësore nën juridiksionin e saj.¹⁹ Kjo nënkupton që KKKP-ja lëshonte vendime, të cilat i nënshtroheshin rishikimit vetëm nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe jo vendimit të rregullt të gjykatës.²⁰

Deri në afatin më 3 dhjetor 2007, AKP-së i janë dorëzuar gjithsej 40,487 kërkesa: 3,206 për pronë banesore, 995 për pronë komerciale me përmirësime dhe 36,285 për pronë komerciale pa përmirësime.²¹ Prej këtyre kërkesave 40,100 kanë qenë për pronësi dhe 387 kanë qenë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës.²²

III. Ndërveprimi ndërmjet gjykatave të Kosovës, KKPB-së dhe KKKP-së

A. DÇPB/KKPB dhe gjykatat: konkurrenca e kërkesave të kategorisë A dhe kategorisë C

¹³ Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10, Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale (16 tetor, 2006). AKP filloi së ekzistuari derisa KKKP-ja akoma i drejtohej kërkesave të parashtruara sipas afatit të KKKP-së deri më 1 korrik 2003.

¹⁴ Po aty

¹⁵ Neni 8, Urdhëresa Administrative 2007/5 (1 qershor, 2007) mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

¹⁶ Neni 2, Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10.

¹⁷ Po aty, neni 10.3 dhe 12.2.

¹⁸ Po aty, neni 13.

¹⁹ Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50

²⁰ Po aty, neni 14.

²¹ Mund ta gjeni në <http://www.kpaonline.org/claimProp.asp>.

²² Po aty.

Përkundër vendimeve të KKKP-së të natyrës së prerë dhe asaj të detyrueshme, ato nuk përmbajnë zgjidhjen përfundimtare të të gjitha çështjeve ligjore të bashkëngjitura kontesteve pronësore. Gjykatat vendore mbajtën juridiksionin “ për të gjykuar ndonjë çështje ligjore për të cilën nuk merret vendim nga KKKP”.²³ KKPB mund “t’i referohej çështjeve që ngriheshin lidhur me kërkesën” që nuk ishin nën juridiksionin e tij “ në gjykatën kompetente vendore ose këshillin administrativ ose tribunalin”.²⁴

Për shembull, KKPB-ja i është referuar kërkesave të kategorisë C për të cilat, kontrata origjinale e blerjes ka pasur mundësi të jetë e mangët në gjykatat vendore për të marrë ndonjë vendim mbi vlefshmërinë e kontratës. KKPB gjithashtu i referohet gjykatave vendore për kërkesat e pasuksesshme të kategorisë A kur parashtruesi i kërkesës nuk ka mundur të paraqes kontratë të vlefshme për shfrytëzim ose nuk ka pasur kurrë në posedim pronën e kontestuar. Gjykatat shpeshherë kanë bërë konkludime mbi çështjet jorelevante që konkurronin me rezultatet e KKPB-së dhe i linin të gjitha palët pa zgjidhje efikase të kërkesës së tyre.

Më 15 korrik 2006, një parashtrues shqiptar i kategorisë A (Pala A) mori vendimin nga KKPB-ja që e drejta e shfrytëzimit të banesës i përkiste palës së paditur, një parashtrues serb i kategorisë C (Pala C) në të njëjtin rast. Ai vendim i KKPB-së referonte Palën A tek gjykata për të përcaktuar nëse ai kishte të drejtë të ndihmës duke u nisur nga fakti që të drejtat e tij të shfrytëzimit pretendoheshin të ishin anuluar në mënyrë diskriminuese dhe i ishin dhënë Palës C. Në shtator të vitit 2006, Pala A paditi Palën C në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës për të kërkuar shfuqizimin e vendimit të KKPB-së, anulimin e vendimit të qeverisë që i jep të drejtat e shfrytëzimit Palës C, anulimit të kontratës në bazë të së cilës Pala C kishte blerë pronën nga Ministria e Financave të Jugosllavisë, si dhe për të konfirmuar që Pala A kishte të drejtën e shfrytëzimit të banesës. Gjykata vendosi në favor të kërkesës së Palës A në plotësinë e saj. Duke bërë këtë, Gjykata në fakt kishte rrëzuar vendimin e KKPB-së, i cili kishte deklaruar Palën C të ishte titullari i të drejtave të shfrytëzimit mbi banesën, duke injoruar faktin që vendimi i KKPB-së ishte i plotfuqishëm dhe i zbatueshëm.²⁵ Në këtë rast, edhe Pala A edhe Pala C kishin kërkesa valide. Në vend të njohjes së vendimit të KKPB-së dhe dhënies së një forme tjetër të kompensimit për Palën A, gjykata dha vendimin në kundërshtim me vendimin e KKPB-së, duke i lënë të dyja palët pa zgjidhje të plotë dhe përfundimtare për kontestin e tyre pronësor.

Në një rast tjetër, në mars të vitit 2006, KKPB refuzoi kërkesën e një shqiptari (Pala A) të kategorisë A mbi një banesë. Kërkesa ishte që banesa i ishte dhënë në shfrytëzim fillimisht Palës A, por ajo dhënie në shfrytëzim ishte revokuar pasi Pala A kishte humbur punën e tij për shkak të praktikave diskriminuese. KKPB-ja kishte vendosur që parashtruesi serb i kërkesës në kategorinë C (Pala C) mbante të drejtën e shfrytëzimit. Shfrytëzimi i banesës i ishte dhënë Palës C, i cili eventualisht e kishte blerë nga Ministria e Financave në Beograd. Në vendimin e tij, KKPB referoi Palën A tek gjykatat lokale për të vendosur nëse kishte ndonjë mjet

²³ Neni 2.5, Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23.

²⁴ Neni 22.1, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/60 .

²⁵ Neni 2.7, Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23.

ligjor në dispozicion. Pala A paditi Palën C në gjykatën e qarkut të Prishtinës. Gjykata anuloi vendimin e KKPB-së duke cituar dispozitat diskriminuese që kishin çuar në revokimin e Palës A, dhe rrjedhimisht humbjen e të drejtës së tij për shfrytëzimin e banesës. Gjykata gjithashtu anuloi kontratën me të cilën Pala C kishte blerë pronën. Gjykata i dha Palës A të drejtën e shfrytëzimit mbi banesën, si dhe e referoi Palën C tek AKP-ja për të parashtruar kërkesë për dëmshpërblim monetar. Ky vendim ishte në kundërshtim të plotë me vendimin e mëparshëm të KKPB-së.

Derisa është e qartë që gjykatat vendore nuk kanë juridiksion të prishin vendimet e plotfuqishme dhe të zbatueshme të KKPB-së, mbetet çështja nëse ekzistojnë apo jo mjete ligjore për këto gjykata në rastet e kërkesave të kundërta të kategorisë A dhe C.

Probleme të ngjashme dalin kur parashtruesi i kërkesës në kategorinë A humb pronën për shkak të praktikave diskriminuese nga ndërmarrjet shoqërore apo publike. Këto kërkesa tani janë nën juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM).²⁶ Në rastet që parashtrohen tek AKM-ja, i vetmi mjet ligjor në dispozicion është kompensimi monetar. Rikthimi i pronës nuk është mundësi.²⁷ Në këto raste, nëse gjykata vendore vendos që parashtruesi i kategorisë A nuk është në gjendje të gëzojë të drejtën e shfrytëzimit për shkak të diskriminimit, është e paqartë se cila kërkesë duhet të mbizotërojë, si dhe cilat mjete ligjore janë në dispozicion.

Kërkesat e parashtruara tek KKPB-ja, KKKP-ja, dhe gjykatat rezultojnë në një metodë tejet të komplikuar dhe shpesh të padobishme të mbrojtjes së të drejtave pronësore. Gjykimet kundërthënëse i lënë palët pa ndonjë zgjidhje të vërtetë të kërkesave të tyre dhe dëmtojnë sundimin e ligjit.

B. Gjykatat nuk shfrytëzojnë vendimet ekzistuese të KKPB-së

Përveç vendosjes së diskriminimit dhe/ose dhënies së parregullt në shfrytëzim për kërkesat kundërthënëse të kategorisë A dhe C, gjykatat vendore kanë filluar të gjykojnë mbi kërkesat në lidhje me të drejtat themelore të pronës për parashtruesit e suksesshëm të kategorisë C.

Neni 7 i Ligjit në fuqi mbi Procedurën Kontestimore i autorizon gjykatat të “[...] verifikojnë edhe faktet që nuk janë paraqitur nga palët, si dhe provat që nuk janë propozuar nga palët [...]”.²⁸ OSBE-ja ka vëzhguar raste në të cilat gjykatat vendore, kur gjykojnë të drejtat pronësore, nuk kanë qenë të vetëdijshme për vendimet ekzistuese të KKPB-së apo KKKP-së në lidhje me pronën e kontestuar. Ndërsa, edhe në rastet kur kanë qenë të vetëdijshme për ato vendime, gjykatat kanë injoruar vendimet e KKPB-së apo KKKP-së. Nëse, për shembull, rezultatet e hetimeve nga KKPB-së apo KKKP-së për të vërtetuar vërtetësinë e provave dokumentare nuk merren parasysh, gjykatat nuk shfrytëzojnë plotësisht dhe me të drejtë gjitha mjetet e domosdoshme për të gjykuar mbi faktet e kontestuar.

²⁶ Neni 2, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/12 mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (13 qershor 2002).

²⁷ Neni 10.3, Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështje që lidhen me Agjencinë e Mirëbesimit të Kosovës (13 qershor 2002).

²⁸ Ligji nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Kosovës, 20 shtator 2008.

Një serb (Pala C) parashtroi një kërkesë të kategorisë C tek DÇPBB/KKPB-jë kundër një shqiptari (Pala A). Gjatë procedurave të KKPB-së, Pala A pretendonte që ajo kishte blerë pronën në mars të vitit 1999. Zyrtarët e DÇPBB-së u munduan të vërtetojnë kontratën e blerjes dhe gjetën që *nuk* ishte e vërtetë. KKPB-ja gjithashtu theksonte që (mbi kërkesën për ri-shqyrtim) që Pala C kishte blerë pronën në bazë të një kontrate të verifikuar në shkurt të vitit 1999. KKPB-ja i kishte dhënë të drejtë kërkesës së Palës C. Më vonë, më 2006, para gjykatës së qarkut në Prishtinë, Pala A kishte paditur për të konfirmuar të drejtën e saj të pronësisë mbi të njëjtën pronë të kontestuar me kërkesën tek DÇPBB-ja/KKPB-ja. Pala A pretendonte të kishte blerë pronën nga i padituri në mars të vitit 1999 me kontratë të paverifikuar të shitjes. Në maj të vitit 2006, në kundërtënie të plotë me vendimin e KKPB-së, Gjykata vendosi në favor të Palës A. Duke marrë parasysh që dosja e gjykatës nuk përmbante informata mbi vendimin e KKPB-së, duket që gjykata nuk kishte njohuri mbi vlerësimin e mëparshëm nga KKPB-ja mbi vërtetësinë e dokumenteve.

Me një kërkesë të dhjetorit 2005, të parashtruar në gjykatën e rajonit të Pejës, një serb (Pala C) kërkonte anulimin e një kontrate pronësore të vitit 2002 të nënshkruar nga një shqiptar (Pala A). Në shkurt të vitit 2005, KKPB-ja i kishte dhënë Palës C të drejtat e shfrytëzimit si parashtrues i kategorisë C. Gjatë procedurës, KKPB-ja kishte hulumtuar nëse dokumentet e ofruara nga Pala A ishin të vërteta apo jo. KKPB-ja vendosi që dokumentet *nuk* ishin të vërteta. Gjatë seancës vijuese gjyqësore, të njëjtët dokumente ishin paraqitur prapë si prova. Gjatë 12 seancave gjyqësore, as gjykata e as Pala A nuk iu referuan vendimit të KKPB-së në lidhje me vërtetësinë e dokumenteve. Përveç kësaj, gjykata asnjëherë nuk hulumtoi vërtetësinë e dokumenteve të shfrytëzuara nga KKPB-së. Në vend të këtyre, gjykata u mbështet vetëm në dëshmitë e dëshmitarëve.

Përkundër vendimeve të KKPB-së që janë përfundimtare, gjykatat duhet të shfrytëzojnë vendimet ekzistuese të KKPB-së, sidomos ato që kanë zbulime faktesh që janë të rëndësishme për rastet në procedurë gjyqësore.

C. Ushtrimi i juridiksionit në rastet që janë nën mandatin e KPA/KKKP apo DÇPBB/KKPB-së

Përkundër dispozitave për juridiksion mbi kërkesat pronësore në lidhje me konfliktin, OSBE-ja ka vëzhguar raste në të cilat gjykatat kanë udhëhequr procedura ku KKKP apo KKPB qartësisht kishin juridiksion ekskluziv. Procedimi i rasteve mbi të cilat një organ tjetër ka juridiksion ekskluziv shkel të drejtën ndaj tribunalit të përcaktuar me ligj.²⁹

Në një rast në rajonin e Gjilanit të parashtruar në janar të vitit 2007, paditësi bëri padi për të dëbuar të paditurin nga prona e tij. Ai pretendonte

²⁹ Neni 6(1), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (Konventa).

të kishte braktisur pronën më 1999 dhe ishte kthyer në dhjetor 2006 për ta gjetur të uzurpuar nga të paditurit. Në korrik 2007, gjykata mori vendimin.

Sipas ligjit për themelimin e AKP-së dhe KKKP-së, AKP-ja dukej të kishte juridiksion mbi këtë rast. Paditësi thoshte të kishte lënë shtëpinë e tij më 1999 dhe ishte kthyer tri javë para se të parashtronte kërkesën. Kështu, rasti do të mund të trajtonte një kërkesë që del nga konflikti i armatosur mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit.³⁰ Gjatë procedurës, gjykatësi asnjëherë nuk mori parasysh se në çfarë kohe gjatë vitit 1999 paditësi kishte braktisur shtëpinë për të përcaktuar nëse AKP-ja kishte juridiksion mbi rastin.

IV. Përfundime dhe rekomandime

Mekanizmat e kërkesave të shumta në Kosovë kanë pasur për qëllim të kontribuojnë drejt zgjidhjes efikase dhe të drejtë të kontesteve pronësore që kanë dalë nga konflikti i vitit 1999 dhe aktet diskriminuese shtetërore gjatë regjimit jugosllav. Përkundër pranisë së këtyre agjencive, gjykatat kanë vazhduar të gjykojnë raste mbi të cilat nuk kanë pasur juridiksion, duke dështuar kështu të trajtojnë plotësisht përcaktimet e mëhershme të KKPB-së dhe KKKP-së, si dhe kanë marrë vendime në kundërtënie me vendimet obligative dhe të zbatueshme të këtyre dy agjencive. Si të tilla, konfuzioni ka qenë shpesh ka ndodhur kur janë trajtuar kërkesat pronësore në lidhje me konfliktin. Duke marrë parasysh pikat e mësipërme, OSBE-ja bën këto rekomandime:

- Gjykatësit dhe avokatët duhet të trajtohen nga Instituti Gjyqësor i Kosovës mbi statusin ligjor të KKPB-së dhe KKKP-së mbi kontestet pronësore.
- Gjykatësit dhe avokatët gjithashtu duhet të trajtohen nga Instituti Gjyqësor i Kosovës për të dhe për të marrë parasysh mundësinë e një vendimi paraprak të KKKP-së dhe KKPB-së.
- Në rastet që kanë të bëjnë me kërkesat dhe parashtruesit e njëjtë, gjykatat duhet t'i marrin parasysh konkludimet e dhëna nga KKPB-ja dhe KKKP-ja.
- Në rastet kur kërkesat kundërtënenëse mes kategorisë A dhe C vihen para gjykatës pas vendimit të KKPB-së apo KKKP-së, gjykatat duhet të marrin parasysh kompensimin monetar të dëmit, e jo rikthimin e pronësisë apo të drejtës së shfrytëzimit tek parashtruesi i kërkesës valide.
- Në rast se AKP-ja fillon të pranojë kërkesa sërish, gjykatat duhet në mënyrë *sua sponte* të vlerësojnë juridiksionin e tyre në kërkesat pronësore në lidhje me konfliktin, duke përfshirë kërkesat në lidhje me humbjen e pronës për shkak të imponimit të masave diskriminuese.
- AKP-ja duhet t'i bëjë gjitha veprimet e nevojshme për t'i ofruar gjykatave vendore një bazë gjithëpërfshirëse të të dhënave mbi gjitha kërkesat dhe vendimet e lëshuara nga KKPB-ja dhe KKKP-ja.

³⁰ Neni 3, Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50.